



Datë: 24.03.2025

Numër Protokolli: 2002/2025

A.nr.286/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.286/2025 të datës 06.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A. H-B., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Kemajl Ademaj nga Ferizaji, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 24.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.286/2025 të datës 06.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A. H-B.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, A. H-B.(*në tekstin e mëtejme referuar ankuesja*), më datë 14.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 872/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015558, të shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për gjashtëmbëdhjetë (16) pozita e punës *Inspektor i Tregut*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.03.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 21.10.2024 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00015558, për gjashtëmbëdhjetë (16) pozitat e punës *Inspektor i Tregut*, me afat aplikimi nga data 22.10.2024 deri më datë 20.11.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit të datës 02.12.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, të njëjtës i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar diplomën e kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës si dhe po ashtu nuk ka ofruar kopjet e dëshmisë së punësimit siq janë vërtetimi dhe kontrata.

Ndërsa, sipas Njoftimit me numër protokolli 166/03 të datës 17.01.2025, të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në organit përkatës të punësimit, rezulton se kandidati J.K me gjithsejtë 79.6 pikë, kandidati A.U me gjithsejtë 78.6 pikë, kandidati I.B me gjithsejtë 75 pikë, kandidatja V.Th-S me gjithsejtë 74.8 pikë, kandidati M.B me gjithsejtë 73.4 pikë, kandidati K.Xh me gjithsejtë 72.4 dhe kandidatja J.K me gjithsejtë 72.4 të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë fitues pozitat e punës *Inspektor i Tregut* në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton njoftimin mbi refuzimin e aplikacionit të datës 02.12.2024 si dhe njoftimin e lartë theksuar për shpalljen e kandidatëve fitues për shkak të shkeljes së dispozitave të së drejtës procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të së drejtës materiale, rrjedhimisht kërkon që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa dhe të ndryshohen njoftimi mbi refuzimin e aplikacionit dhe ndryshimi i njoftimit mbi kandidatët fitues apo të anulohen njoftimet e sapo theksuara dhe lënda të kthehet në rivendosje tek organi i administratës.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë dhe duke u bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati V. D, si kandidatë pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015558, më datë 27.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.213/2025, të datës 17.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015558, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për gjashtëmbëdhjetë (16) pozitat e punës *Inspektor i Tregut*, në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.213/2025, të datës 17.03.2025, është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015558, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet

ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.286/2025, të datës 06.02.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.286/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokat Kemajl Ademaj;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.